




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



“Orange Net” L.L.C.
Numri i biznesit - 810055815
Pronar - Elhami HAZIRI & Avni HAZIRI
Orange NET
Gjilan



VENDIM

për ndërprerjen e licencës të Operatorit të Shpërndarjes Orange NET , me seli në Gjilan

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Orange NET është operator i shpërndarjes i licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale përmes rrjetit kabllorë, në pajtim me Rregulloren KPM-2016/01, me seli në Gjilan. KPM, me datën 30 tetor 2013, ka marr vendim për dhënien e licencës për operatorin e shpërndarjes Orange NET .
3. Më datën 13 dhjetor 2019, pronari i operatorit të shpërndarjes Orange NET, përmes një shkrese të dorëzuar në KPM me anë të e-mailit, ka njoftuar se heq dorë nga licenca e operatorit të shpërndarjes.

Arsyetimi

4. Duke marrë parasysh njoftimin e pronarit të operatorit të shpërndarjes Orange NET , për heqje dorë në mënyrë vullnetare nga licenca, Komisioni konstaton se ka bazë të mjaftueshme për ndërprerjen e licencës së Orange NET .

Vendim

5. Komisioni në takimin e tij, të mbajtur më datën 31 janar 2020, merr vendim për ndërprerjen e licencës së operatorit të shpërndarjes Orange NET në bazë të njoftimit për heqje dorë në mënyrë vullnetare nga Licenca e KPM-së.
6. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.



Muja FERATI

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



04.02.2020

datë